

Zbatimi planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve në Bashkinë Lezhë

Konteksti

Kontributi i dldp-së në sektorin e menaxhimit të mbetjeve gjatë 2016 është fokusuar kryesisht në planifikimin sektorial dhe në zhvillimin e mekanizmit të ofrimi të shërbimit bazuar në performancë, i cili do të përcaktojë standardet minimale të përballeshme për shërbimin.

Gjatë 2016 dldp dhe IKU kanë mbështetur Bashkinë Lezhë në hartimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve, gjithashtu edhe në përgatitjen e dokumenteve të tenderimit për nen kontraktimin e shërbimit.

Qëllimi dhe objektivi i projektit në 2017

Qëllimi i projekt është të mbështesë Bashkinë Lezhë në zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në mënyrë që të përmirësojë menaxhimin financiar dhe qëndrueshmërinë ekonomike të sektorit.

Projekti është i fokusuar në 3 shtylla kryesore:

- **Monitorimi i shërbimit**
- **Mbledhja e të ardhurave**
- **Komunikimi/Informimi publik**

Mësimet e nxjerra nga zbatimi i aktiviteteve në këto tre shtylla do të përdoren për të rishikuar kurikulën mbi monitorimin dhe zbatimin e shërbimit për Bashkinë Lezhë.

Përfituesit e projektit

Përfituesit kryesorë të projektit janë bashkia Lezhë dhe banorët e kësaj bashkie, të cilët do të përfitojnë një shërbim të përmirësuar.



Aktivitetet

Aktivitetet e mëposhtme janë pjesë e projektit sipas çdo shtylle:

- **Monitorimi i ofrimit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.**

Ngritja dhe përgatitja e një organigrame dhe Terma Reference për secilin nga anëtarët e Grupit të Punës së Monitorimit. Asistencë e vazhdueshme e grupit të monitorimit dhe vlerësimit për të realizuar procesin, t bazuar planin e monitorimit dhe vlerësimit.

- **Mbledhja e të ardhurave**

Përgatitja dhe hartimi i një modeli tarifimi i cili do t'iu shpërndahet klientëve, rishikimi i bazës së të dhënave ekzistuese të klientëve dhe asistencë në konsolidimin e data baze-s se krijuar.

Asistencë për stafin e bashkisë në lidhje me zhvillimin dhe tej përmirësimin e rregulloreve mbi përmirësimin e bazës së të dhënave dhe detyrimeve e penaliteteve.

- **Komunikimi/Informimi publik**

Përgatitja e strategjisë së komunikimit me qytetaret dhe grupet e interesit mbi

shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe monitorimi i aktiviteteve të komunikimit me publikun.

Përgatitja e një liste me kanalet e komunikimit që do të përdoren për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe tarifatat të cilat përfshijnë materialet për printim, spotet televizive dhe reklamata radiofonike.

FAKTE KRYESORE

PARTNERËT

- dldp – Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal
- Bashkia Lezhë

KOHËZGJATJA

- Shkurt 2017 - Nëntor 2020

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. "Asim Vokshi", Nd 14 Ent. 11,
Ap. 56
Tirana, Albania
Tel: +355 4 2256840

E-mail: zvokopola@uri.org.al

Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.